

MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM


Nr. 286, dt. 13.12.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 13.12.2016, pasi shqyrtoi kërkesën për licensim në fushën e restaurimit për Z. Genc Hajdari,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për pajisje me license restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë B “Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale”, me nënkategorinë B/1, B/2 sipas rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit” të z. Genc Hajdari
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, pajisjen e z. Genc Hajdari me license restaurimi personale profesionale në fushën e restaurimeve për kategorinë B “Projektim e zbatim në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale”, me nënkategorinë B/1, B/2.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR  
ARTA DOLLANI